



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **28**

Prishtinë, më 9.10.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Andin Hoti, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Salih Zyba.

Munguan: Etem Arifi, Lutfi Zharku, Srđan Mitrović, Liburn Aliu, Danush Ademi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 2.10.2018;
3. Raportimi i AUV për farërat dhe plehrat në Kosovë;
4. Të ndryshme.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2.10.2018

Kryetari i komisionit konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 2 tetor 2018 do të miratohet në mbledhjen e radhës, me plotësimin e z. **Salih Zyba** në pikën e fundit për plotësimin e planit vjeshtor të punës: **të vizitohet qendra e homologimit dhe kontrollit teknik të automjeteve** .

3. Raportimi i AUV për farërat dhe plehrat në Kosovë

Kryetari konstatoi se anëtarja e komisionit nga LDK pajtohet të jetë aktive lidhur me këtë pikë ndaj fjalën ja dha përfaqësuesve nga AUV **Ismet Fejzullahu** dhe **Ibrahim Hoxha** dhe njoftoi komisionin se kjo pikë e mbledhjes përcjellët nga disa grupe të interesit siç janë shoqatat e fermerëve, ndaj ky debat do të jetë si parapërgatitje për të organizuar komisioni më vonë një tryezë. Z. Fejzullahu theksoi se importi i farërave dhe plehrave ne Republikën e Kosoves përcaktohet ne bazë te ligjeve si : Ligji i Kosoves për Farërat nr.2003/5, si dhe Ligji për Plehrat

Artificial ne Kosove nr. 2003/10, te cilat përcaktojnë vlerësimin e farërave dhe plehrave, përcaktimin e llojeve te tyre qe përdoren ne Republikën e Kosoves, kontrollin e importit, prodhimin, paketimin, etiketimin, transportin, magazinimin, vendosjen e tyre ne treg, si dhe përcaktimin e kriterëve per regjistrimin e tyre ne "Listën nacionale te farërave dhe plehrave" . Ne baze te këtyre ligjeve janë hartuar edhe një varg udhëzimesh administrative te cilat përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësite qe kane te bëjnë me ndërmarrjen e masave te cilat kane për qëllim qe ne tregun e Republikës se Kosoves te importohen farëra dhe plehra qe plotësojnë standardet ndërkombëtare te cilësisë.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, përmes inspektoreve fitosanitare gjate importit ne ketë periudhe ka intensifikuar kontrollet për te gjithë operatorët e biznesit, te çilet importojnë farëra dhe plehra kimike per përdorim ne bujqësi, me qëllim te inspektimit te ngarkesave qe importohen nga shtetet tjera duke u siguruar se farërat dhe plehrat e importuara i përmbushin kriteret e cilësisë.

Te gjithë operatorët e biznesit te çilet realizojnë importin e farërave dhe plehrave, paraprakisht duhet te pajisen me licence për importin e tyre ne Republikën e Kosoves. Për pajisjen me licence operatorët e biznesit i nënshtrohen procedurave te verifikimit, nëse i plotësojnë kërkesat e parapara për licencim sipas Iegjisiacioni ne fuqi.

Operatorët e licencuar sipas procedurave te lartpërmendura, te çilet arrijnë te marrin pëlqimin nga inspektorët fitosanitar regjistrohen ne regjistrin e importuesve te plehrave dhe farërave, qe menaxhohet dhe përditësohet nga MBPZHR, dhe e cila është përgjegjëse për lëshimin e Licencave për import te farërave dhe plehrave artificiale.

Ne baze te te dhënave qe disponon MBPZHR, operatorët e biznesit për import te farërave dhe plehrave ne Republikën e Kosoves jane si ne vijim;

AlfaTrade SHPK Skenderaj, Eurocoop DPT, Viti Agromarket KSDOO Craqanice ,Agrounion SHPK Sllatine BIetaNPT Suhareke, ThermoSHPK Podujeve, Agronorni SHPK Rahovec, Fitofarma NTP Ferizaj, Agroflorencë SHPK Kline, Ideal Group SHPK Peje, Progres DPT Prilluzhe.

Te gjitha farërat dhe plehrat qe importohen ne Kosove, janë ne "Listën nacionale te farërave dhe plehrave", te miratuara nga MBPZHR,te cilat janë te publikuara ne uebfaqen e Ministrisë.

Gjate periudhës Janar - Tetor 2018 (02.10.2018), sasia e grurit te importuar për fare është 2,549 ton, ndersa sasia e importit te plehrave minerale është 40,150ton.

Besa Gaxherri tha se raporti është i cekët dhe si e tillë lë vend për vërejtje edhe nga qytetarë-fermer. Zyrtarët e pranishëm, vazhdoi ajo, vetë pranuan se ka më tepër të dhëna sesa që janë shkruar në raport ndaj pyeti zyrtarët e AUV a kontrollojnë të gjitha kompanitë pasi që konstatimi i jokontestueshëm është se nuk kemi cilësinë e duhur si të farërave ashtu edhe plehrave dhe fermerët çdo vit e më tepër dëmtohen por nuk e meritojnë këtë, sa kompani veprojnë ilegalisht, çfarë është cilësia e këtyre dy produkteve, a ka inspektim, çfarë masa janë ndërmarr në praktikë, të dhënat e doganës çka tregojnë. **Z. Fejzullahu** u përgjigj që secila kompani në kufi duhet me i plotësua kushtet ligjore : kërkesa, certifikata, diploma, procesi i inspektorit fitosanitar, pagesa për dy vite si dhe detaje tjera dhe asnjë kontingjent nuk hyn pa licencë dhe pa kontrollin e inspektorëve fitosanitar, kurse për plehra mjafton kualifikimi me shkollë të mesme bujqësore por duhet ta ketë. Nëse ka dyshime, vazhdoi, malli ndalohet derisa nga IBK kthehet analiza, pastaj asgjësohet nëse del i dyshimtë në praninë e inspektorëve, këtë vit kanë qenë dy raste të asgjësimit të mallit të dyshimtë. Këtë vit janë importuar 2000 kg farë misri, 3000 kg farë patate.

Ibrahim Hoxha shtoi se nga 1 janari deri tash janë marrë 158 mostra në kufi dhe të gjitha në bazë të analizave janë brenda parametrave të rregullta. Nuk mund të konstatohet se cilësia e farërave dhe plehrave nuk janë në rregull pa pasur rezultate, konstatoi ai. Gjatë kësaj periudhe të importit, 48 mostra në kufi janë marrë dhe asnjë nuk ka rezultuar negativ.

Në vazhdim disa anëtarë zhvilluan bashkëbisedime dhe sqarime lidhur me temën si kryhen veprimet e kontrollimit nga AUV, por dilemat ishin pse AUV konstaton rregullsi kurse shumë fermer sjellin fakte të kundërta, këtë fakt zyrtarët e AUV sqaronin se kjo bëhet nga zyrtari e jo nga fermeri, ngase është lista nacionale dhe duhet të dihet ku merret mostra.

Salih Salihu, u ndërlidh me konstatimin se rendimenti varet nga cilësia e farës dhe plehrave, ndërsa në Kosovë kemi rendimente të ultë për shkak të cilësisë së fareve dhe plehrave. Potenco i një rast ku plehu 15x15x15 në bazë të analizave ka dalë se është i cilësisë së dobët 4x4x4 dhe ka qenë import nga Greqia. Prandaj duhet me rritë kontrollin e cilësisë së importit të tyre në këtë sezon të mbjelljeve, me anë të analizave të shpeshta. **Kryetari dhe z. Salihu** u pajtuan me mendimin se këtu dikush po e mshf të vërtetën, ngase ekziston fakti për farëra me cilësi të dyshimta.

Salih Zyba shprehu gjithashtu mendimin se raporti i dërguar nuk i plotëson nevojat e një raporti pikërisht sepse konstaton “janë edhe shumë tjera”, pra çka janë ato tjera, sa janë dhe si janë.

Pyetje bëri si vijon : a ndalohen këto importe deri të dalin rezultatet ?

A ka mjaftueshëm inspektorë fitosanitarë ?

A ka masa që janë ndërmarrë për bizneset, psh a u janë marë licencat?

Cili është bashkëpunimi në mes AUV-MBZHR, inspektorët komunale dhe me fakultetin e bujqësisë ?

A përputhet shqetësimi i fermerëve me shqetësimin e AUV në lidhje me cilësinë e farës ?

Ganimete Musliu parashtrori pyetje a ka pas tendencë për hyrje ilegale të farërave?, Kush është prodhuesi i 10.000 tonë farërave në Kosovë (fakti që u cek nga Salih Salihu), A janë të rrezikuar fermerët në Kosovë nga farërat dhe plehurat jodicilësore?, A kontrollohen edhe lokalet përveç kontrollit në kufi.

Ismet Fejzullahu tha se gjithsesi përputhen shqetësimet e AUV me atë të fermerëve por është fakti tjetër se bujqit për farë përdorin grurin e vet dhe kjo krijon një zinxhir duke i dhënë njëri tjetrit, në anën tjetër kompetencat e inspektorve ndërlidhën vetëm me tiketë dhe nuk prodhohet një varietet Kosovar. Lidhur me pyetjen e ndalimit tha se kjo bëhet gjithsesi, bllokohen derisa të kthehen rezultatet nga IKB në Pejë dhe licenca nuk i vazhdohet nëse është rezultati negativ.

Për **z. Zyba** shqetësuese ishte se bujqit e përdorin grurin e vet për farë.

Vazhdoi **z. Fejzullahu** se rezultatet e analizave në 10 vitet e fundit të plehrave nga inspektorët e bujqësisë nuk kanë gjete raste të dyshimta. Mostrat nuk duhet ti merr vet bujku por inspektori për shkak të profesionalizmit.

z. Hoxha dhe z. Fejzullahu nga AUV, ishin unik me mendimin se deri tani mostrat e marra për farëra dhe plehra nuk kanë treguar asnjë parregullsi. Pyetja se a janë të mjaftueshëm inspektorët, gjithsesi jo, sepse ka nevojë për më shumë inspektorë. Bashkëpunimi mes institucioneve ekziston, është bërë kërkesa që edhe inspektorët komunalë të veprojnë në ombrellën e agjencisë, por ligji akoma nuk është miratuar. Për kontrabandimin e farërave tha se nuk kanë informacione.

Salih Salihu, si përmbledhje tha se a është fara e mire dhe plehu i mirë tregojnë më së miri rezultatet duke përmend disa raste problematike, megjithatë AUV e cila është më e rëndësishme se AKI, nuk është në nivel të detyrës që e ka sipas ligjit.

Salih Zyba, konstatoi se përgjigjet ishin reale por gjendja është e keqe në terren, ndaj falënderoi për njoftime zyrtarët prezent kurse për shkak të problemeve lidhur me këtë temë, si komision që ka drejt të mbikëqyr, nëse do të ketë ankesa nga fermerët, do të monitorohet ligji përkatës përmes vizitave në AUV ose aty ku është e nevojshme.

Besa Gaxherri, ripërsëriti disa nga pyetjet me konstatim se ka argumente të mjaftueshme që gjendja në terren nuk është e mirë, prandaj kërkoj që të plotësohet raporti : sa inspektime janë bërë ?, cilat kompani janë, sa raste të dyshimta janë dhe çka është ndërmarr ?

Kryetari Muharrem Nitaj, duke falënderuar të ftuarit nga AUV, në emër të shumicës së anëtarëve që diskutuan kërkoi që të plotësohet raporti duke shprehur pakënaqësinë me gjendjen në terren dhe drejtën e deputetëve që të kërkojnë përgjegjësi për këtë.

Ismet Fejzullahu, gjithashtu falënderoi dhe potenco i faktin se AUV është e hapur për çdo argument apo shkelje që dikush e inicion nga komisioni, raportin me plotësime premtoi se do ta kompletojnë shpejt, por shtoi se AUV vepron me 12 inspektorë në tërë Kosovën dhe presin ligjin e ri për plotësime të domosdoshme.

4. Te ndryshme

Këtë pikë **Kryetari** filloi me konstatimin se duhet të deklaroi të përfunduar ngase nuk ka kuorum, megjithatë **Ganimete Musliu** kërkoi, për shkak se anëtarët e LDK marri pjesë në disa komisione dhe votojnë, mos të potencohet në të ardhmen nga anëtarët e komisionit nga LDK mosvotimi në komision. Mirëpo reagoi **Besa Gaxherri** se çështja e marrjes pjesë të anëtarëve të komisionit në mbledhjet e komisionit është e rregulluar në bazë të konstatimeve të Gjykatës Kushtetuese ku ata mund të marri pjesë por mos të votojnë njashtu si veprohet nëpër mbledhjet plenare, ngase komisioni gjithashtu paraqet trup të Kuvendit. Me iniciativën e **Salih Salihut** kryetari do të ftoi ministrin e bujqësisë të mërkurën në një takim, ku mundën me marr pjesë edhe anëtarët e komisionit, rreth temave aktuale sidomos për mundësinë e kontrollimit më efikas të mostrave të dyshimtë të farërave dhe plehrave.

Mbledhja përfundoi në orën 14,30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Muharrem Nitaj